



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:016581

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05831357

**C.nr.715/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Emine Hoti në çështjen kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr.Lidhja e Pejës, Magj.Prishtinë- Fushë Kosovë, pa nr, ndaj të paditurit N.J, me numër personal 1012547257, Rr “ Vëllezërit Frashëri” Nr.89-Gjilan, me objekt kontesti rimbursimi i dëmit material dhe jomaterial, jashtë seancës gjyqësore, më datë 18.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.Pranohet** marrëveshja për zgjidhje të ndërmjetësuar, e arritur pranë Qendrës së Ndërmjetësimit në Gjilan, e dates 10.06.2023, në çështjen kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë me shifrën Cnr.715/2024, ndaj të paditurit nga Gjilani.

**II.**Ky aktvendim është i plotëfuqishëm që nga data 18.06.2024.

**A r s y e t i m**

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, ka ushtruar padi me objekt kontesti rimbursimi i dëmit material dhe jomaterial, ndaj të paditurit N.J nga Gjilani, Në pajtim me nenin 9.1 dhe 9.6 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, rasti i është dërguar për zgjidhje paqësore Qendrës së Ndërmjetësimit në Gjilan, të cilët këtë rast e kanë zgjidhur sipas nenit 12 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, ashtu që rastin e zgjidhur me ndërmjetësim të datës 10.06.2023, ia kanë dërguar gjykatës për aprovim.

Gjykata konstatoi faktin se rasti i zgjidhur me ndërmjetësim, i plotëson kushtet ligjore për t'u aprovuar nga gjykata, pasi që palët lirisht mund të disponojnë me të drejtat për të cilat janë marrë vesh në zgjidhjen e rastit.

Nga të cekurat më lart e konform nenit 411.1 të LPK-së dhe nenit 14 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin nr. 06/L-009, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2024:016581, 18.06.2024**

Gjyqtari  
Berat Spahiu

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.